



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 688 Prot.

Tiranë, më 28.06 2018

VENDIM Nr. 108, datë 14.05.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 14.05.2018, pasi shqyrtoi Raportin mbi vëzhgimin arkeologjik në *KP 215+00, territori i Strukturave Bregdetare të Seksionit Detar të Gazsjellësit TAP, zona e Semanit, (Fier)*- subjekti "TAP AG", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin mbi vëzhgimin arkeologjik në *KP 215+00, territori i Strukturave Bregdetare të Seksionit Detar të Gazsjellësit TAP, zona e Semanit, (Fier)*- subjekti "TAP AG", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Subjekti "TAP AG" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "*Struktura Bregdetare të Seksionit Detar të Gazsjellësit TAP, zona e Semanit, (Fier)*", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

